



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj.37301/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupime pjesmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Shinasi Berisha nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6 par 2 të ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.12.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Fatos Shinasi Berisha, i lindur më 06.10.1966 në Prishtinë, tani jeton në lagjen Ulpiana U 1 Hy. 5 nr.19, i martuar baba i një fëmije, Regjisor. Drejtor në Qendren Kinematografike të Kosovës, i gjendjes mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si Drejtor në Qendren Kinematografike të Kosovës, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurise deri në afatin e fundit ligjor 31 mars 2011, në Agjencionin kundër korrupsionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave të Zyrtareve të Larte Publik.

Me kete mos veprim, ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 2 të ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, andaj

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 500 (pesqindë) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e të hyrave gjyqsore KGJK-se nr. 100-4300-700-0518. Pagesa bëhet në ndonjeren agjenci-Banke për mbledhjen e të hyrave, përmes urdherpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 33 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj kërkesën nr. 01 4103/10 të dt. 24.10.2011, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Fatos Berishes, për kundërvajtjen nga neni 6 paragrafi 2 të Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se ka pasur shume angazhimeve në pune dhe për këtë shkak ka harruar ta kryej këtë obligim, pasi është hera e parë që kryen punë në Institucionet shtetërore të Kosovës dhe përkushtuar të jap kontributin e tij maksimal. Gjithashtu ka deklaruar se nuk ka ndonjë asistent në punë i cili do të ndihmonte. Ka këkuar nga Gjykata ti merr parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe premtion se herave te tjera do të jete shumë me i kujdeshem, duke shtuar se është i perkushtuar ti respektoj obligimet e dala nga Institucinet e Kosovës.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e

merr parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe premtën se herave tejera do të jete shumë me i kujdeshem. duke shtuar se është i perkushtuar ti respektoj obligimet e dala nga Institucinet e Kosoves.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të njaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmangët kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrorjné ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtari
Lindita Jakupi

